

NATURE AND CULTURE IN MITRUSH KUTELI'S NARRATIONS NATYRË DHE KULTURË NË RRËFIMET E MITRUSH KUTELIT

Neli NAÇO¹

¹Department of Albanian Language and Literature,

Faculty of Education and Philology, "Fan S. Noli" University, Korçë, ALBANIA

*²Corresponding author e-mail: nelinaco@hotmail.com

Abstrakt

Rrëfimi i Mitrush Kutelit përfaqëson një dukuri interesante në letërsinë shqiptare edhe sepse është në një lidhje organike me kulturën autentike shqiptare. "Kënaqësia e tekstit" buron nga një lidhje e pashkëputur me traditën, nga "riprekja" e teksturës autentike kulturore nëpërmjet tekstit të përpunuar të rrëfimit. Në disa raste kemi verifikuar shumë qartë praninë e binomit natyrë – kulturë sipas modelit të Lévi-Strauss-it në veprën e Kutelit. Ky fenomen është trajtuar shumë qartë në një nga hipostazat e tij nga Agron Tufa në artikullin e titulluar *Kulturfilozofia e tregimit "Lumi i Madh" të Mitrush Kutelit*. Por na është dukur interesant fakti që krahas këtij trajtimi fenomeni natyrë – kulturë është i përfaqësuar edhe me hipostaza të tjera në veprën e Kutelit. Kryesisht ne e kemi verifikuar atë veç rrëfimit të sipërpërmendur "Lumi i Madh" edhe në rrëfime të tjera me një natyrë krejt të ndryshme, por që na thërresin me konceptin e kulturës nganjëherë në një hipostazë krejt simetrike si ajo që Lévi-Strauss-i jep në veprën e tij *Tropikë të trishtë*. Këtë ngjashmëri e kemi trajtuar kryesisht nëpërmjet krahasimit të konceptit Strauss-ian dhe konceptit kulturor të rrëfimit "Fshati im e pi rakinë". Në një mënyrë më diskrete ky fenomen del edhe në rrëfimin "Kryengritje për lugat" ku personazhet bëhen bartës të kësaj lufte të brendshme që përfaqëson natyra dhe kultura. Në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër kemi ndërhyrjen e fenomenit në përgjithësi në konstruktin rrëfimor të veprës ndaj themi që ky fenomen është i rëndësishëm të trajtohet me koherencë sepse nuk është thjesht një fenomen që përfaqëson vetveten brenda rrëfimit, por në të njëjtën kohë konstrukton qartazi strukturat rrëfimore të veprës së artit.

Fjalë çelës: Rrëfimet e Mitrush Kutelit, natyra, kultura, miti, folklori.

Abstract

Mitrush Kuteli's story represents an interesting phenomenon in Albanian literature although it is in close connection with authentic Albanian culture. "Text satisfaction" stems from an unparalleled connection to tradition, from the "reproduction" of authentic cultural textures through elaborate narrative text. In some cases we have verified very clearly the presence of the binom: nature – culture, according to Lévi-Strauss's model, in Kuteli's work. This phenomenon is dealt with very clearly in one of his hypostasis by Agron Tufa in the article entitled "The Cultural Philosophy of Mitrush Kuteli's "Great River" story. But it seemed interesting to us that besides this treatment, the phenomenon of nature – culture is represented by other hypostases in Kuteli's work. At most, we have verified it in addition to the aforementioned story "The Great River" as well as in other stories of a very different nature, which sometimes lead us to the concept of culture in a completely symmetric hypostasis such as that of Lévi-Strauss's in his work entitled "Sad Tropics". This similarity is mainly dealt with by comparing Strauss's concept and the cultural concept of the narrative "My Village Drinks Raki". In a more discrete way, this phenomenon also emerges in the narrative "Rebellion for the Bogey" where the characters become carriers of this internal war represented by nature and culture. In one way or another, the phenomenon

generally intervenes in the narrative construct of the work; this is the reason we say that this phenomenon is important and it has to be treated with coherence because it is not merely a phenomenon that represents itself within the narrative, but, at the same time, it clearly constructs the narrating structures of the work of art.

Keywords: Kuteli's narrations, nature, culture, myth, folklore.

1. Hyrje

Rrëfimet e Mitrush Kutelit sjellin natyrshëm, si rrallëherë në letërsinë shqipe, edhe botën e kulturës shqiptare me gjithë plotninë e vet. Kuteli regjistron me përpikëri, rrjedhshmëri, autencitet dhe larmishmëri gjithë atë që do ta vlerësojë si pjesë integrale e kulturës shqiptare. Baza e regjistrimit të kësaj kulture është hapësira e ngushtë e qytezës (fshatit) dhe rrethinave ku kultura është e paprekur, e pastër, në forma të purifikuara. Kjo sepse disa koncepte të romantizmit janë të pranishme në formimin kulturor të shkrintarit dhe ai e konsideron këtë si një pjesë të rëndësishme që të ndërtojë bashkë me rrëfimin edhe kulturën popullore shqiptare në rrëfim. Procesi i natyrshmërisë që e bart rrëfimi vetvetiu, pasurohet me ndërtimin e brendshëm kulturor shqiptar që e bën rrëfimin e Kutelit të receptohet prej lexuesve nga gjithë hapësirat shqipfolëse. Në këtë punim kemi sjellë disa dallime të konceptit binar natyrë – kulturë. Kultura dhe natyra sjellin një kundërshti plotësuese. Kultura si krijim njerëzor sjell vlerat dhe antivlerat e veta. Atje ku rrezikohet sistemi natyral, ekuilibrat prishen dhe ajo që njeriu krijon mund të bëhet edhe e rrezikshme. Por vlerat kulturore si mentalitete janë mjaft interesante për t'u studiuar sepse ato zbulojnë detaje të ndërtimit kulturor të shoqërisë njerëzore dhe njeriut. Leximi i këtyre detajeve e bën qenien njerëzore të kuptohet në plotninë e vet me gjithë vlerat relative që krijon ajo. Ndaj jemi ndalur në studimin e këtij raporti në veprën rrëfimtare të Mitrush Kutelit.

2. Natyrë dhe kulturë në prozën “Lumi i Madh”

Duke u marrë me një letërsi të një lloji të caktuar që ka lidhje të ngushtë me produktin kulturor kolektiv, me rrëfimet, përrallat, tregimet e përditshmërisë, ritualet e të tjera, nuk mund të mos e shohim rrëfimin Kutelian edhe si një produkt kulturor që u nënshtrohet ligjeve strukturore të ndërtimit ku ndër kryesorët është dallimi binar kulturë – natyrë i pranuar tashmë si universal për të gjithë kulturat.

E ka vënë re së pari këtë dallim Agron Tufa duke u përqendruar tek studimi i një nga prozave më interesante të Mitrush Kutelit që ka të bëjë pikërisht me natyrën. Kjo është proza “Lumi i Madh”. Studimi titullohet “Harmonia që kushtëzon rendin e organizimit të botës” me nëntitull *Kulturfilozofia e tregimit “Lumi i Madh” të Mitrush Kutelit*.¹ Në hulumtimin e vet Tufa shprehet:

“Prandaj duke objekt të ligjërimit këtë tregim, shpall menjëherë se “Lumi i Madh” është në ndër tregimet më të veçanta të Kutelit dhe ndoshta i vetmi në letërsinë shqipe për kah problematika e pazakontë që trajton, – atë të gjetjes së një ekuilibri etik të bashkekzistencës së njeriut me natyrën.”²

¹ Agron Tufa, *Kuja e Mnemozinës*, pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2010, faqe 201 – 206.

² *Po aty*, faqe 201.

Ky tregim është interesant, dhe në një pikëpamje unik, sepse është i vetmi tregim ku marrëdhënia e njeriut me natyrën është një marrëdhënie e shprishur. Njeriu i shoqërive që ndodhen dhe jetojnë pranë natyrës në përgjithësi është një marrëdhënie më të mirë me natyrën se sa njeriu i epokave të zhvilluara që përpiqen që ta shfrytëzojnë atë në mënyrë të pafundme, deri në fundin e saj. Tregimi i Kutelit është, ose tingëllon, si një parapritë e gjendjes moderne kur kjo marrëdhënie tenton të shprishet dhe deformatet.

Tregimi ka të bëjë kështu me dy ide të formave të ngjashme. Ai rreh t'i afrohet një universaleje që përfaqëson këtë raport binar në rang përgjithësues, për gjithë njerëzimin që është implikuar në prishjen e këtij raporti, duke i kushtuar rëndësi ruajtjes së natyrës për të shmangur hakmarrjen e saj. Por shkrimtari rreh njëkohësisht që të krijojë një bindje që në këtë marrëdhënie të shprishur të binarit natyrë – kulturë, njeriu shqiptar e ka në qenien e vet kulturore, në ndërtimin e vet kulturor, a në arkitekturën e vet kulturore, këtë shprishje. Në një kuptim njeriu shqiptar është ndërtuar (edukuar) kështu, të mos e respektojë natyrën para zhvillimit dhe shpalljes së kulturalitetit të tij. Kjo është gjëja që ai e shpall më së shumti dhe më me forcë.

“Lumi i madh” hapet në këtë mënyrë:

“Njerëzit – të mirë a të ligj, të bukur a të shëmtuar, të pasur a të varfër – vijnë e shkojnë, po Lumi ynë i Madh lumë ishte, lumë është. Kur me ujë shumë e kur me ujë pak, vërtet, po atë ma ke aty për jetë e mot, kurse unë e ti, or tungjatjeta, sot jemi, nesër s’jemi.”³

Kjo është dhe kredoja e rrëfimit të “Lumit të Madh” përkohshmëria dhe qëndrueshmëria e natyrës brenda sistemit binar natyrë – kulturë. Nga pikëpamja gjuhësore ata që i përkasin pjesës së vlerave kulturore janë gjithmonë të përkohshëm. Të mirë dhe të ligj, të bukur a të shëmtuar, të pasur a të varfër përbëjnë një kompleks vlerash të ngritura mbi ligje estetike, ligje ekonomike ose juridike, ligje morale e të tjera brenda kuadrin të kulturës përgjithësisht dhe këto vlera janë të luhatshme, të tjetërsueshme, të zhdukshme krejtësisht bashkë me njeriun (qenien) sepse “unë e ti, or tungjatjeta, sot jemi, nesër s’jemi”, por vlerat natyrale sipas kredos autoriale janë të patjetërsueshme sepse Lumin (Natyrën) “ma ke aty për jetë e mot”. Kuteli ka shprehur me rrëfimin një ide strukturale antropologjike që konstruktohet edhe si një filozofi e përvojës nga Claude Lévi – Strauss.

“Bota ka filluar pa njeriun dhe do të mbarojë pa njeriun. Institucionet, doket e zakonet, që do të kisha kaluar jetën time për t'i inventarizuar dhe për t'i kuptuar, janë një lulëzim kalimtar i një krijimi në raport me të cilin ato nuk zotërojnë asnjë kuptim, ndoshta përveç atij që t'i lejojnë njerëzimit të luajë rolin e vet. Ky rol nuk i jep një vend të pavarur dhe përpjekja e njeriut – edhe pse e dënuar – është t'i kundërvihet më kot një rënieje universale; ai vetë duket si një makinë, ndoshta më e përkryer se të tjerat, që punon për copëtimin e një rendi origjinal dhe gremis një lëndë të organizuar fuqimisht, drejt një inercie gjithnjë e më të madhe që do të jetë një ditë përfundimtare.”⁴

Mitrush Kuteli artikulon nëpërmjet një proze artistike, një dukuri mirëfilli antropologjike dhe kulturore, ai artikulon nëpërmjet të thjeshtës së vëzhguar edhe paralajmërimin e gabimit modern. Në një rrëfim tradicional parandërton ngjarjen arketip të këtij binomi natyrë – kulturë e cila është një realitet i kohës moderne. Ky rrëfim është i pazëvendësueshëm dhe unik. (Shih edhe njëherë citimin nga Agron Tufa të bërë më sipër.)

Nga gjithë tregimet që ka krijuar Mitrush Kuteli ky është i vetmi ku kultura, kultura shqiptare, kultura njerëzore në tërësi shihen si njëloj dhe nën goditjen mesianike të një ideje korrigjuese. (Shih gjithashtu edhe kapitullin mbi Mesianizmin në veprën e Kutelit.)

³ Mitrush Kuteli, *Vepra I*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990, faqe 348.

⁴ Claude Lévi – Strauss, *Tropikë të trishtë*, Çabej, Tiranë, 1998, faqe 455.

Natyra dhe kultura këtu, në këtë rrëfim, në të vetmin rrëfim të Mitrush Kutelit, dhe mbase edhe në të vetmin krijim fikcional të letërsisë shqipe janë në një marrëdhënie tejet delikate. Kuteli kudo shpall një dimension të kulturës, (po e përdorim këtë fjalë gjithnjë në kuptimin antropologjik ashtu siç kuptohet edhe në marrëdhënien binare natyrë – kulturë), në veprën e tij, kjo kulturë është tërheqëse dhe dinamike, ajo është diferencuese dhe e pa parashikueshme, por asnjëherë nuk hyn në marrëdhënie të rrezikshme me natyrën. I vetmi fiksim ku shfaqet rreziku është ky. Dhe ky i jep statusin që e pat vënë re Agron Tufa në studimin e tij mbi këtë vepër.

3. Natyrë dhe Kulturë në prozën “Fshati im e pi rakinë”

Por cilësimi i kulturës njerëzore, i një kulture të veçantë ose minikulture, i kulturës shqiptare për ta dalluar atë nga kultura të tjera, nga minikultura të tjera ose kultura joshqiptare, ekziston edhe në rrëfime të tjera të Mitrush Kutelit. Ai është shkrimtari që i përdor këto dallime kulturore për të realizuar një përfshirje letrare të lexuesit në një plan interesant, lexuesi ndihet i përfshirë kulturalisht në receptim. Me një shprehje gjuhësore Kuteli në disa prej rrëfimeve të tij realizon përfshirjen kulturore në receptim. Këto shprehje gjuhësore fraza shpallin kryesisht si *Kulturë* atë që mendon rrëfimtari se është e njëjtë dhe unifikuese. Dimensioni *Kulturë* shpallet si zotërues dhe unifikues i entitetit, dimensionet e tjera nuk kanë rëndësi. Nocioni i fshatit është dhënë shpeshherë si nocion i një minikulture. Çdo aspekt minikulturor zhvillohet si një aspekt kulturor dhe mbi atë aspekt shpallet kultura e minigrupit (fshatit).

Ja si shprehet rrëfimtari në rrëfimin “Lugetërit e fshatit tonë”:

“Shok-o, nuk di fshatrat e tjera, po fshati ynë është rëngë me lugetër”⁵

Minigrupi kulturor (fshati) është plot me lugetër dhe diferenca midis tyre është pikërisht prej këtij dallimi quasi kulturor. E quajtmë një dallim quasi kulturor sepse prania e lugetërve do të thotë njëkohësisht për njeriun rustik edhe prani e tyre (e cila besohet plotësisht), por edhe prani e shumë rrëfenjave për lugetër e kanxhalozë.

Rasti qartësohet edhe më tej nëse do të marrim në shqyrtim një rrëfim tjetër si për shembull rrëfimi “Fshati im e pi rakinë”. Në këtë rast kulturologjema *rakia* është ajo që bën dallimin i cili është kulturor (minikulturor) sepse nuk përjashton tërësisht rastin e të pirit të rakisë prej fshatrave të tjerë, por megjithatë dallimi është i madh. Sidoqoftë autori pretendon që ky fshat e pi rakinë dallueshëm nga të tjerët, nga fshatrat e tjerë, nga bota tjetër, pra vendos një dallim kulturor midis gjendjes së fshatit të vet dhe fshatrave të tjerë.

Le të shohim hyrjen e rrëfimit “Fshati im e pi rakinë”:

“Jo se më shket mendja të ngrihem e të them se fshatrat e tjerë nuk e pinë rakinë, po si e pi ky fshati im s’ka fshat në botë.”⁶

Ky rrëfim është diferencuar njësisht kulturore (fshati) nga çdo njësi tjetër kulturore, çdo fshat tjetër rreth e rrotull, në veri a në jug, gegë apo toskë. Dallimi kulturor është më i rëndësishëm se dallimi gjenealogjik, racial apo krahinor. Ky dallim kulturor, në fakt, bëhet baza që personi i dallueshëm të dallohet prej të tjerëve edhe nga pikëpamja e origjinës dhe fisit. I gjithë dallimi kulturor është shndërruar kështu në një lojë e cila i dallon qeniet sipas një zhvillimi kulturor, gjendja e tjetrit pranë natyrës, pa tiparin kulturor dallues, pa atë që e njëjtëson me grupin (pirjen e rakisë dhe prodhimin e saj) është shenjë prapambetjeje, mungese civilizimi, qenësi në një grup tjetër më të ulët kulturalisht.

⁵ Mitrush Kuteli, *Vepra 2*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990, faqe 295.

⁶ Mitrush Kuteli, *Vepra 2*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990, faqe 266.

Këto situata prodhojnë humor çuditërisht edhe në rrethana të mirëfillta etnologjike. Claude Lévi – Strauss dëshmon për një situatë dallimi kulturor ku misionari vëzhgon vizatimet në trupat e indigjenëve amazonianë në Brazil. Le të shohim rrëfimin etnologjik të dhënë nga Lévi – Strauss:

“Sado neveri të ndiejë misionari është i ndërgjegjshëm se këto piktura u japin indigjenëve një rëndësi të dorë së parë dhe se ato janë në një kuptim, vetë qëllimi i tyre.

Ai gjithashtu denoncon ata burra që humbasin ditë të tëra për t’u pikturuar, duke harruar gjahun, peshkimin dhe familjet e tyre. “Pse jeni kaq kokëtrashë?” u thonin ata misionarëve. “Dhe pse qenkemi kokëtrashë?” thoshin këta të fundit. “Sepse ju nuk lyheni si Eyiguayeguis-ët.” Duhej të ishte i pikturuar për të qenë burrë, ai që mbetet në *gjendje natyrore* nuk dallohet nga kafsha.”⁷

Gjendja *natyrore* është për njeriun primitiv e papranueshme. Në rrëfimin kulturor Kutelian është pronësia, të pasurit e kazanit të rakisë, mjetit që e prodhon atë që gjeneron diferencën kulturore. Ke apo nuk ke kazan rakisë, përkthehet kulturalisht je apo nuk je nga fshati. Situata prodhon humor gjithashtu sepse dallimi kulturor nuk mbështetet në veçori të qenësishme, por në veçori të zgjedhura nga individët e grupimit kulturor.

“Se ai që ka një kazan, është mbret më vete e të shikon që lart, si hipur më tatrivan, sa mezi ta kthen mirmëngjesin.

Mund të kesh ti: ara sa të mundësh, gështenja sa të lodhesh e tregti të rëndë, me dengje – puna jote – po s’pate kazan numërohesh fundi i fshatit e pa nder. Ti mund të jesh aty në fshat den – baba – den, nga gjyshi e stërgjyshi e më tutje, po gjithë i huaj je për defter e fshatit. Mokrar ishte, mokrar je, e fjalë s’ka!”⁸

Mokra është një krahinë e lidhur kulturalisht me qytetin e Pogradecit; me fshatin në rastin tonë, si vendndodhja bazë e zhvillimit kulturor të rrëfimit kutelian. Shumë familje të vjetra të qytetit janë me origjinë nga Mokra. Por në përgjithësi disa norma kulturore të komunitetit synojnë thellimin e dallimeve kulturore që në të vërtetë nuk janë të thella. Të thuash je nga Mokra si në frazën “Mokrar ishte, mokrar je, e fjalë s’ka!” është ta krahasosh njeriun qytetas, (për shkak të mospërputhjes së këtyre normave bazë të kulturës, siç është zotërimi i një kazanit rakisë), me malësorin. Njeriun që jeton në zona të thella malore. Krahasimi merr vlerë akoma më të qëndrueshme sepse Mokra është një krahinë malore e qarkut të Pogradecit.

Në të vërtetë qyteza me paragjykimet e saj ka pasur disa “norma shtrënguese” që kërkonin një lloj asimilimi të plotë dhe të padiskutueshëm të njerëzve, në përputhje me normat e saj kulturore.

4. Natyrë dhe Kulturë në prozën “Kryengritje për lugat”

Natyra dhe kultura me gjithë kompleksitetin e vet dhe marrëdhënien e vet të ndërlikuar, të shumëfishtë, por gjithsesi e mbetur në kundërvënien binare të sipërpërmendura natyrë – kulturë, është pasqyruar edhe në formën e besimeve pagane formave animistike që i kemi përshkruar më sipër.

Tregimet që japin më me hollësi këtë pjesë të botës animistike janë “Lugetërit e fshatit tonë” dhe “Kryengritje për lugat”. Tregimet japin me hollësi këtë botë animistike të përshkruar dhe interpretuar si dukuri antropologjike më sipër. Ajo që na tërheq më së shumti nga pikëpamja interpretative është tanimë është vetë marrëdhënia natyrë – kulturë në këto rrëfenja. Kjo

⁷ Claude Lévi – Strauss, *Tropikë të trishtë*, Çabej, Tiranë, 1998, faqe 229.

⁸ Mitrush Kuteli, *Vepra 2*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990, faqe 269.

marrëdhënie duket se ekziston sepse tregimet (sidomos tregimi “Lugetërit e fshatit tonë”) është ndërtuar mbi reflektimin e kësaj marrëdhënie binare.

Ne i japim marrëdhënies binare natyrë – kulturë në një kuptim të përgjithshëm brenda veprës së Kutelit e cila i ka interesuar atij që të përqendrojë shkrimin kryesisht në pjesën kulturore (më poshtë do ta quajmë atë memorje kulturore), por kjo memorje kulturore (kultura) shfaq dashur, padashur edhe marrëdhëniet me natyrën.

Kuteli e shpërfaq lidhjen e natyrës me kulturën në hyrjen e rrëfenjës “Lugetërit e fshatit tonë”. Shohim si fillon rrëfenja:

“Shok-o, nuk di fshatrat e tjera, po fshati ynë është rëngë me lugetër”⁹

Fjalja e parë dëshmon që ndarja kulturore mund të ekzistojë; fshatrat e tjerë edhe mund të mos kenë lugetër, por në artikulimin e ngjarjes kulturore për autorin nuk kanë rëndësi rrëfenjat nga fshatrat e tjera, ai artikulon ngjarjen(t) kulturore nga fshati i tij. E rëndësishme për rrëfimtarin është që fshati i tij është plot dhe ai mund të rrëfejë nga pozitat e kulturës së tij. Kjo i jep rrëfimtari popullor statusin e atij njeriu që është i dallueshëm për kulturën e vet. Përsëri ne mund të përsërisim frazën (e sapo përmendur më sipër) e cila tregon marrëdhënien e njeriut me atë që ai e ka krijuar vetë dhe e quan kulturë. Gjendja *natyrore* është për njeriun primitiv e papranueshme. Në rrëfimet për lugetërit ky njeri (disi arkaik) ka besimin se lugetërit ekzistojnë. Ky besim i tij është pjesë e kulturës vetanake dhe kolektive; ai beson në lugetër dhe është aq i ndërgjegjshëm për këtë besim saqë nuk do t’ia dijë nëse fshatrat e tjera besojnë në këtë kategori kulturore apo jo.

Kjo pjesë e zhvillimit kulturor është delikate në një rrëfim tjetër. Ekuilibri që është vendosur në *besimin*, si një produkt kulturor, ka filluar të priset. Në rrëfenjën “Kryengritje për lugat” i biri i Qipros, ka filluar të luftojë *besimin*, rrjedhimisht produktin kulturor, gjë që shkakton një acarim të madh tek bashkëvendësit e tij. Ata duan ta ndëshkojnë fizikisht të birin e Qipros sepse nuk beson tek lugetërit. Tendenca e tij është të kthejë njeriun në një gjendje tjetër ku ky besim kulturor nuk duhet të ekzistojë. Tregimi është i mbushur me humor, gjendja e dyfishtë e rrëfimit “Lugetërit e fshatit tonë” është e tejkaluar.

Lexuesi është kryesisht i përfshirë në anën e birit të Qipros, sepse lexuesi vetë e ka tejkaluar këtë gjendje kulturore. Ai, në gjendjen aktuale të leximit të rrëfimit, nuk beson në lugetër që do të thotë se ky konflikt ku të gjithë besojnë dhe njëri nuk beson është më i madh se do të dukej në realitet. Djali i Qipros ka lexuesin në anën e vet. Edhe rrëfimtarin njëkohësisht, i cili me mënyrën e rrëfimit të tij shkakton një humor i cili tejkalon nuancat humoristike të rrëfimit “Lugetërit e fshatit tonë”. Ekuilibri kulturor është me tendenca të qarta të disekuilibrit, dhe gjendja e njeriut “primitiv” shkakton të qeshura tek lexuesi “bashkëkohor”. Këtë ekuilibër të shprishur e tregon ky fragment i njohur për humorin e tij të gjallë.

“Që kur i doli të birit të Qipros fjala se nuk beson në lugat, humbi nderë e dashurinë e fshatit, si në turq e në kaurë. Jo vetëm se s’ka njeri që ia kthen mirmëngjesin, jo vetëm se i thonë mason e papistan, po ia paskan ngjitur se nga pun’ e tij – që s’beson lugat! – perëndia i punon fshatit tonë kaq alamete e valoma.

Bie shi shumë e vjen Lumi i Madh: fajin e ka çuni i Qipros!

Nuk bie shi e thahet misri: fajin e ka çun’ i Qipros!

U bie gëlbaza dhenve: fajin gjithë çuni i Qipros!

E gjithë çuni i Qipros e ka fajin se u bie hiri vreshtave, se ikën peshku nga kufiret tona e se i hyri krimbi arrës së Banushit

E jo vetëm kaq, po i paska dalë fjala se valla ha bukë me të madhë e shejtanëve.”¹⁰

⁹ Po aty, faqe 295.

¹⁰ Po aty, faqe 199.

Fundi i këtij rrëfimi është një pohim kulturor. Ai dëshmon që varianti parësor gojor që ka shfrytëzuar Kuteli është një pohim kulturor për forcën e qëndresës kulturore të kolektivit. Varianti gojor që ka shfrytëzuar Kuteli për rindërtimin e ngjarjes (një lloj hipoteksti oral) na shpërfaq fare qartë që individi (djali i Qipros) ndëshkohet dhe e pëson prej mosbindjes së tij. Ne e lexojmë (e kuptojmë gjithashtu) një tekst ndryshe nga ata që e kanë rrëfyer atë së pari. Në rreshtat e mësipërm lexuesi qesh me besimin e komunitetit që gjithë të këqijat vijnë nga djali i Qipros, në rreshtat mbyllës komuniteti qesh me ndëshkimin që merr biri i Qipros si pasojë e mosbesimit të tij në normat kulturore të komunitetit. Përfundimisht djali i Qipros “shkelësi i normave kulturore” është i ndëshkuar, rrjedhimisht hipoteksti oral i Kutelit është vjelë prej anëtarëve të komunitetit që besojnë në këto norma kulturore (jo prej djalit të Qipros ose ndonjë ndjekësi të tij). Ai ndëshkohet nga komuniteti dhe qeshet prej tij në rrëfim. Leximi ynë me leximin e njeriut primitiv kulturor “përplasen” duke krijuar një lloj gjendjeje “kontrapunktuale” në përfundimin e rrëfenjës

References

- [1]. Agron Tufa, *Kuja e Mnemozinës*, pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2010..
- [2]. Mitrush Kuteli, *Vepra 1*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.
- [3]. Mitrush Kuteli, *Vepra 2*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.
- [4]. Mitrush Kuteli, *Vepra 3*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990..
- [5]. Claude Lévi – Strauss, *Tropikë të trishtë*, Çabej, Tiranë, 1998.